

Subjekti promovues

Grandi Navi Veloci spa (më tej e quajtur GNV) me seli ligjore në Calata Marinai d'Italia - 90146 Palermo dhe seli operative në Via Balleydier 7 - 16149 Genova kodi fiskal dhe nr. nipt 13217910150 e regjistruar në Dhomën e Tregtisë së Palermos R.E.A. 268303.

Hapësira

Veprimtaria zhvillohet në territorin italian.

Lloji i emërimit

“MyGNV”

Kohëzgjatja

Nisma do të jetë e vlefshme nga data 1 maj 2019 deri në 30 prill 2020.
Kërkesa dhe përdorimi i kuponave për pazarin brenda datës 30 prill 2022.

Qëllimi

Promovimi i shërbimeve Ferry GNV duke vlerësuar besimin e klientëve.

Përfituesit

Të gjithë pasagjerët e regjistruar të pajisur me fidelity card MyGNV

Mënyra e pjesëmarrjes

GNV organizon nismën në fjalë e cila vlerëson pjesëmarrësit duke u dhënë kuponë që ofrojnë ulje për shërbimet GNV, siç tregon tabela më poshtë. Kuponët mund të merren falë blerjes së biletave të tragetit GNV kur arrihen pikët e treguara në tabelën më poshtë.

Për të marrë pjesë në këtë nismë është e nevojshme të jeni të regjistruar ose të regjistrohëni në fidelity card GNV. Regjistrimi është falas dhe mund të bëhet lirshëm nga çdo pasagjer.

Pasi të jetë plotësuar korrektësisht regjistrimi dhe të jetë kryer hyrja e parë, pjesëmarrësi do të marrë një email me kodin e pjesëmarrjes që e identifikon në program dhe që i lejon, gjatë çdo blerjeje, të transformojë vlerën e blerjes në pikë të cilat herë pas here, duke u grumbulluar japin mundësinë që të përfitohen kuponët në dispozicion.

Pjesëmarrësit mund të hyjnë përmes internetit në një seksion web privat në brendësi të sitit web www.gnv.it, në të cilin do të mund të konsultojnë: rregulloren e veprimtarisë, pikët e gjeneruara nga blerja e biletave; mund të ndryshojnë të dhënat e tyre; mund të fshijnë pjesëmarrjen nga nisma.

Është detyrë e pjesëmarrësve që të komunikojnë, brenda maksimumi 30 ditë nga data e blerjes së biletave, gabime të mundshme në kalimin e pikëve qoftë edhe për shkak të ngatërresës së kodit personal.

Mënyra e grumbullimit të pikëve:

Për të grumbulluar pikët pjesëmarrësit duhet të kërkojnë në momentin e blerjes së biletës së udhëtimit përputhjen e biletës GNV me kodin e tyre të pjesëmarrjes. Vlera e grumbulluar njihet në bazë të vlerës së paguar dhe vetëm në rast se shërbimi i blerë do të përdoret.

Kalimi i pikëve do të kryhet pasi të jetë kryer udhëtimi.

Përjashtohen nga grumbullimi pikët e biletave të strukturuar si opsione dhe para-shitje.

Vlera e biletës do të shndërrohet në pikë sipas këtij raporti:

1 pikë baraz me 10 euro të biletës së blerë:

Do të jetë e mundur të përputhen pikë mbi kodin e pjesëmarrjes në përputhje me datën e shtypjes së biletës përmes të gjithë kanaleve.

Do të jetë gjithashtu e mundur të përputhen pikët pas kësaj date dhe 30 ditë brenda datës së udhëtimit, ekskluzivisht përmes hapësirës së rezervuar My Gnv (mygnv.gnv.it)
Grumbullimi efektiv i pikëve do të kryhet vetëm pasi të ketë përfunduar udhëtimi, prandaj në rast anulimi të biletës ose mos përdorimi të saj nuk do të grumbullohet asnjë pikë.
Kuponët mund të kërkohen vetëm në rast se është arritur një prej niveleve të parashikuara.

Biletat, për tu njohur si të vlefshme, duhet të kenë si titullar pronarin e kartës MyGnv.

Kreditë me pikë i jepen çdo kodi pjesëmarrjeje dhe llogariten duke u bazuar mbi shpenzimet neto të kryera nga përfitimi i kuponëve të shpenzimit nga ana e klientit, uljet, rimbursimet, etj...

I njëjti person nuk mund të marrë pjesë me më shumë kode dhe pikë të përfituara përmes përputhjes së kodit të pjesëmarrjes me titullin e udhëtimit, janë personale dhe për këtë arsye nuk do të mund të këmbehen ose kalohen nga një person në tjetrin.

Për të mundësuar realizimin e nismës GNV aktivizon përmes një sistemi të posaçëm informues i cili numëron blerjet e kryera në biletari me kodin e pjesëmarrjes dhe përditëson pikët në rast se tërhiqet kuponi.

Për të përfituar nga benefitet e programit, pjesëmarrësit duhet të ruajnë dhe të paraqesin biletat origjinale që janë blerë dhe janë përdorur në rast se ato u kërkohen.

GNV i rezervon vetes mundësinë për të shtuar, gjatë nismës, aktivitete të tjera promovimi për të lehtësuar pjesëmarrësit. Në veçanti, do të mund të parashikohen zgjatje të nismës, kuponë shtesë ose kushte më të favorshme për pjesëmarrësit.

Në përgjithësi, këto kushte do tu komunikohen pjesëmarrësve përmes materialit publicitar të vënë në dispozicion nga GNV në sitin web www.gnv.it dhe në seksionin web privat të rezervuar për çdo pjesëmarrës.

Kërkesa e kuponëve

Kur të arrihet niveli i pikëve që parashikohet për të tërhequr kuponët, pjesëmarrësi do të mund të kërkojë kuponë, që përkojnë me një ulje sipas asaj që parashikohet në tabelën më poshtë.

Pas kërkesës, GNV do të kryejë kontrollet mbi korrektësinë e biletave që kanë gjeneruar këtë kredi pikësh.

Kuponët lëshohen përmes kodit në brendësi të zonës së vet personale ose përmes Contact Center.

Kuponët duhet të kërkohen të paktën 5 ditë jave përpara datës së nisjes.

Për çdo lloj informacioni tjetër mund të dërgohet një email në adresën: mygnv@gnv.it.

Kuponët mund të tërhiqen nga personat që kanë të drejtë në momentin e grumbullimit të pikëve të parashikuara nga niveli i dëshiruar dhe mund të kërkohen në çdo moment brenda datës 30 prill 2022.

Kuponët

Kuponët janë ulje që mund të përdoren për blerjen e biletave të traqeteve GNV. Pjesëmarrësit mund të përdorin kuponët kur të kenë arritur shumën e pikëve të treguara më poshtë:

Nivelet e pikëve	Çmimet
200 pikë	Kupon prej €. 50,00
400 pikë	Kupon prej €. 100,00

600 pikë	Kupon prej €. 150,00
800 pikë	Kupon prej €. 200,00
1 000 pikë	Kupon prej €. 250,00
1 200 pikë	Kupon prej €. 300,00
1 400 pikë	Kupon prej €. 350,00

Bileta me ulje do të lëshohet nga GNV pasi të jetë kontrolluar disponueshmëria e vendeve. Bileta do të dërgohet me email.

GNV do ti japë mundësinë të gjithë pjesëmarrësve që do të kenë grumbulluar pikë deri më datën 30/04/2019 në nismën e mëparshme promovionale që të ri-plotësojnë pikët akoma në dispozicion. Këto pikë do të përputhen me nivelet e reja, sipas një faktori konvertimi që i lejon klientit të ruajë shumën e Kuponëve të grumbulluar deri në atë moment.

Në këtë mënyrë pikët do të konvertohen dhe do të mund të përdoren deri më datën 30/04/2022.

Kuponi nuk aplikohet mbi taksa të mundshme të parashikuara mbi biletë.

Për do biletë mund të përdoret vetëm një Kupon. Kuponët e përshkruar më sipër nuk janë të grumbullueshëm midis tyre dhe nuk janë të grumbullueshëm me kuponë të tjerë dhe/ose ulje të dhëna përmes kodit coupon.

Kuponi mund të përdoret edhe për blerjen e biletave që kushtojnë më pak sesa kuponi, në këtë rast kuponi nuk jep të drejtë për të marrë asnjë resto dhe nuk do të mund të përdoret për shpenzime të tjera.

Kuptohet që pjesëmarrësi nuk do të ketë të drejtë për një kalim të pikëve në rast se anulon biletën me të cilën i ka përdorur.

Nuk parashikohen zgjatje kohore ose lëshime të tjera të kuponëve që nuk janë përdorur brenda kohës së përcaktuar.

Përveç të tjerash kuponi:

- Nuk mund të copëtohet dhe duhet të përdoret në një herë të vetme;
- Nuk rimbursohet ose shndërrohet në lekë;
- Është personal;
- Nuk mund të transferohet tek palë të treta nga ana e pjesëmarrësve. Shoqëria promovuese i rezervon vetes të drejtën për të kryer kontrollet e nevojshme;
- Nuk mund të grumbullohet me nisma promovionale të GNV, përveç rasteve kur kjo e fundit vepron ndryshe.

Për të gjitha aspektet në lidhje me biletën dhe transportin duhet respektuar rregullorja në fuqi që ndodhet në "Kushtet e Përgjithshme të Transportit" të GNV.

Trajtimi i të dhënave personale.

Të dhënat personale të Përfituesve do të trajtohen në përputhje me atë që parashikohet nga Rregullorja Evropiane (UE) 2016/679 për sa i përket mbrojtjes së personave fizikë në lidhje me trajtimin e të dhënave personale, edhe përmes përdorimit të instrumenteve elektronike, për qëllimet e lidhura me përfundimin e plotë të kësaj nisme.

Për më shumë informacione konsultoni website-in <https://www.gnv.it/images/pdf/it/privacy.pdf>

Të tjera

GNV i rezervon vetes të drejtën për të ndryshuar, edhe pjesërisht, në çdo moment, mënyrën e funksionimit dhe pjesëmarrjes në nismë duke publikuar këto ndryshime në sitin web www.gnv.it dhe në seksionin web privat të çdo pjesëmarrësi.

Përfundimi normativ i Veprimtarisë me Kupon

Deklarohet se në bazë të nenit 22-bis të D.L. Nr. 91/2014 i hyrë në fuqi gjatë kalimit nga L. Nr. 116/2014, ka ndërruar nenin 6, presje 1 të D.P.R. Nr. 430/2001, konsiderohen të përjashtuara nga përkufizimi i konkurseve dhe veprimeve me Kupon “veprimtaritë në të cilat, përballë një shpenzimi të përcaktuar, me apo pa nivel hyrës, Kuponët përbëhen nga kuponët që duhen përdorur mbi shpenzime të kryera më pas në të njëjtën pikë shitjeje që ka lëshuar këta kuponë ose në një tjetër pikë shitjeje që bën pjesë në të njëjtin rrjet ose sipërmarrje”.

Data e saktë:

Për të përcaktuar datën e saktë të kësaj rregulloreje deklarohet se është firmosur me firmë dixhitale dhe vulë sipas Kodit të Administrimit Dixhital D.Lgs. 7 mars 2005 nr.82 dhe ndryshimet e mëtejshme.